

VENDIM
Nr. 63/2013

PËR MËNYRËN E TRAJTIMIT TË DEPUTETËVE

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 19 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit”, të ndryshuar, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Paga ditore e deputetit llogaritet mbi pagën bazë, pa përfshirë shpërblimet dhe mbulimin e shpenzimeve. Paga e deputetit përcaktohet sipas nenit 13 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar.

II. Për çdo mungesë pa shkaqe të përligjura në seancat plenare të Kuvendit, deputeti i ndalohej paga ditore. Mungesë pa shkaqe të përligjura, për efekt page, quhet çdo mungesë, përjashtuar rastet kur, me miratimin e Kryetarit të Kuvendit, deputeti merr pjesë në veprimtari parlamentare brenda ose jashtë vendit.

Kryetari i Kuvendit përcakton me udhëzim mënyrën e evidentimit të pjesëmarrjes së deputetëve në seancë plenare.

III. Përveç pagës bazë, deputeti shpërblehet për pjesëmarrje në mbledhje të komisionit të përhershëm ku bën pjesë. Në këtë rast, masa e shpërblimit është 2 000 lekë për çdo mbledhje.

IV. Masa e shpërblimit për kryetarët e komisioneve të përhershme të Kuvendit është 2 500 lekë dhe për kryetarët e nënkomisioneve është 2 200 lekë për çdo mbledhje.

V. Kryetari i grupit parlamentar merr 5-15 për qind mbi pagën e deputetit, në raport me numrin e anëtarëve të grupit.

VI. Pjesëmarrja në komisionet e përhershme paguhet deri në 12 mbledhje në muaj, ndërsa në komisionet e posaçme paguhet sipas vendimit të Kuvendit për krijimin e tyre. Pagesa bëhet sipas listëprezencës së pjesëmarrjes së deputetëve në komisione, të firmosur nga kryetari i komisionit dhe sekretari teknik, dhe verifikohet nga procesverbali i mbledhjes përkatëse të komisionit. Ngarkohet shërbimi i komisioneve dhe sektori i trajtimit të deputetëve të bëjnë verifikimet për çdo rast.

VII. Deputetët që banojnë në rrethin e Tiranës përfitojnë dieta ditore deri në 6 ditë në muaj, ndërsa deputetët që banojnë jashtë rrethit të Tiranës përfitojnë dieta ditore deri në 12 ditë në muaj. Deputetët i përfitojnë dietat pas dorëzimit të dokumentacionit vërtetues, të firmosur nga ana e tyre. Forma e dokumentacionit vërtetues përcaktohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

VIII. Kuvendi mbulon shpenzimet telefonike për deputetët përgjatë gjithë vitit, për vlerën mujore prej 17 000 lekësh. Për kryetarët e komisioneve të përhershme dhe kryetarët e dy grupeve parlamentare më të mëdha vlera mujore është 20 000 lekë.

IX. Kuvendi mbulon shpenzimet për strehimin e deputetëve. Mënyra e përmbushjes së këtij detyrimi përcaktohet me vendim të Byrosë së Kuvendit.

X. Kuvendi mbulon shpenzimin për pagesën e tarifës së pajisjes me pasaportë diplomatike vetëm për deputetët, gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit.

XI. Pagesat e llogaritura sipas pikave VII, VIII dhe IX kalojnë me transfertë në llogarinë personale bankare të deputetit, pas datës 20 të çdo muaji.

XII. Vendimi i Kuvendit nr. 68, datë 20.2.2003, “Për mënyrën e trajtimit të deputetëve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

XIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 26.11.2013